



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 13 Korrik 2021

Nr: 102

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 59, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 12.07.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 13.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Relator
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijan RUSMALI - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Organizata “Qëndresa Qytetare”

OBJEKT: Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 59, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 12.07.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124/1, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 59 regj., datë 12.07.2021.

Në mbledhjen e datës 13.07.2021, ora 13:00, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 59 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 17, pika 3, shkronjat “a” e 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 59, datë 12.07.2021, të paraqitur nga organizata “Qëndresa Qytetare”.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 14 Korrik 2021, në orën 11:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

